



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Nr. 02-34/22-06

Prishtinë, më 19 tetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 86 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në Kosovë,
5. Interpelanca e ministrit të shëndetësisë, Sadik Idriz, sipas kërkesës së GP të ORA-s,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi të që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një Deklaratë, me të cilën e kundërshton përfshirjen e Kosovës në preambulën e Kushtetues së Serbisë.

Kryetari kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen për kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetarët e grupeve parlamentare: **Alush Gashi** (LDK), **Gjylnaze Syla** (AAK) **Teutë Sahatçiu** (ORA), **Xhezair Murati** (6 plus) dhe **Numan Baliq** (për Integrim) deklaruan se e mbështesin propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----86;
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta kundërshtuar përfshirjen e Kosovës në preambulën e Kushtetues së Serbisë. Ngarkohen kryetarët e grupeve parlamentare ta harmonizojnë tekstin e Deklaratës dhe Kuvendit t'ia paraqesin për miratim.

Deputeti **Emrush Xhemajli** (LPK) kërkoi që kërkesa e shtatë deputetëve për organizimin e referendumit për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur sovran dhe të radhitet në rend dite të kësaj seance.

Kryetari i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen rreth këtij propozimi.

Kryetarët e grupeve parlamentare:**Alush Gashi** (LDK),**Jakup Krasniqi** (PDK),**Gjylnaze Syla** (AAK) dhe **Teutë Sahatçiu** (ORA) deklaruan se e mbështesin përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e shtatë deputetëve.

Ferid Agani dhe Gjerg Dedaj (për Integrim) kërkuan që kërkesa e shtatë deputetëve të hidhet në votim.

Deputeti Hydajet Hyseni tha se janë paraqitur dy nisma, të cilat nuk e përjashtojnë njëra tjetrën. Kjo duhet të përmbyllet me një vendim të këtij Kuvendi për të nisur procesin e hartimit të Kushtetutës së Kosovë. Prandaj, Grupi që do të themelohej do të duhej të hartonte një tekst që do t'i sintetizonte këto çështje.

Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, tha se shumica e qytetarëve të Kosovës mendojnë njësoj për të ardhmen e saj. Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka proceduar me kërkesën e deputetëve sipas kompetencave të saj dhe ka vendosur që kjo çështje të shtyhet

për shumë arsye, të cilat janë cekur në përfundim. Jemi në një situatë, të cilën duhet ta kalojmë bashkë.

Mendimi im personal është që çështja e ngritur duhet të shtyhet për një kohë të përshtatshme.

Ky Kuvend ka votuar Grupin Negociator, i cili është në proces të punës.

Nuk është mirë të dilet nga ky proces, për të cilin jo vetëm ne, por edhe bashkësia ndërkombëtare, ka kontribuar shumë. Ndonjëherë po harrohet se për këtë proces është bërë shumë mund dhe është derdhur shumë gjak, të cilin nuk guxonte ta shkel askush.

Duhet të jemi në nivel të përgjegjësive që i kemi për hir të së ardhmes sonë të përbashkët.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës plenare të 9 e 10 tetorit 2006 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Gani Koci** pati pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Haki Shatri, por ai nuk ishte i pranishëm për t'u përgjigjur.

Deputetja **Sala Berisha** pati pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Haki Shatri, por ai nuk ishte i pranishëm për t'u përgjigjur.

Deputeti **Husnija Beshković** pyeti ministrin e Transportit dhe të Postëtelekomunikacionit lidhur me arsyet e mbylljes së vendkalimit në Çakor të Pejës.

Ministri **Qemajl Ahmetim** u përgjigj pyetjes së deputetit Beshković.

Deputet **Nazim Jashari** pyeti ministrin e Arsimit lidhur me ndërtimin e një shkolle në pjesën veriore të Mitrovicës.

Ministri **Agim Veliu** u përgjigj në pyetjen e deputetit Jashari.

Deputetja **Qibrije Hoxha** pyeti ministrin e Punëve të Brendshme lidhur me stacionimin e njësisve patrulluese të SHPK-së.

Ministri **Fatmir Rexhepi** u përgjigj në pyetjen e deputetes Hoxha.

Deputetja **Qibrije Hoxha** pyeti ministrin e Arsimit lidhur me pagesën e studentëve për paraqitjen e provimeve.

Ministri **Agim Veliu** u përgjigj në pyetjen e deputetes Hoxha.

Deputeti **Hydajet Hyseni** ripërsëriti pyetjen për Qeverinë e Kosovës lidhur me mënyrën shpenzimit të mjeteve për zbutjen e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit.

Përgjigjja mbeti për seancën e radhës, ngase askush nga kabineti qeveritar nuk ishte i pranishëm për t'u përgjigjur në pyetjen e deputetit Hyseni.

4. Shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët se shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në vend është radhitur për shqyrtim me kërkesë të deputetit, Xhavit Haliti, të miratuar në seancën e mëparshme. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga ministri i Punëve të Brendshme të përgatitë një informatë për gjendjen e sigurisë në vend.

Ai propozoi që koha për diskutime të zgjasë pesë minuta, për secilin deputetë që dëshiron të diskutojë. Kuvendi miratoi këtë propozim.

Kryetari e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme t'i informoi deputetët e Kuvendit për gjendjen e sigurisë në vend.

Ministri **Fatmir Rexhepi** tha se në bazë të kërkesës së Kryesisë së Kuvendit

Ka organizuar takimet me eprorë të lartë të SHPK-së dhe me Zyrën e Komisarit Ndërkombëtar për Polici, për të përgatitur një raport analitik për gjendjen aktuale të sigurisë, si dhe për krimet që kanë ndodhë në Kosovë prej vitit 2000 deri në shtator të këtij viti.

Përkundër angazhimeve të institucioneve, të mekanizmave të sigurisë dhe të rendit, ambienti i sigurisë së përgjithshme në Kosovë, kohëve të fundit u godit nga një seri aktesh kriminale, ku qytetarët me të drejtë ngritin shqetësimet, duke adresuar përgjegjësinë tek institucionet relevante në zbulimin dhe kapjen e aktorëve, si dhe të sponsorëve të të gjitha krimeve.

Njëri nga standardet që duhet plotësuar është edhe fusha e sigurisë, e cila dukshëm është përmirësuar nga mbarimi i luftës, por që akoma duhet të forcohet, sepse kishim momente që luhatën stabilitetin dhe sigurinë e përgjithshme. Kështu vetëm gjatë periudhës gusht – tetor 2006, aktet kriminale në: Klinë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj etj. treguan rrezikun potencial nga veprimet e grupeve të ndryshme kriminale, në destabilizimin e situatës dhe në shqetësimin e popullatës, por edhe në provokimin e institucioneve gjatë procesit të bisedimeve, si dhe sigurinë e përgjithshme, për çka, edhe janë vlerësuar dhe ngritur masat e sigurisë. Në të gjitha rajonet janë shtuar efektivat policore në disa pika, si dhe janë ngritur ekipet e veçanta të vëzhgimit dhe të kontrollit gjatë 24 orëve.

Zhvillimet në veri të vendit dhe integrimi i qytetit të Mitrovicës gjatë kësaj faze, mbeten faktorë potencialë, që reflektojnë në çështjet e sigurisë së brendshme, në gjithë vendin. Aktualisht siguria edhe në këtë pjesë të vendit mbahet nën kontroll nga ana e KFOR-it, e policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së, kështu janë vlerësuar dhe ngritur masat e kontrollit në interes të sigurisë së qytetarëve.

Po ashtu veprimet disavjeçare të grupeve dhe shërbimet e fshehta në Kosovë, si dhe aktivitetet e agjenturave serbe në pjesë të ndryshme të Kosovës, bëjnë që prania e tyre të jetë potencialisht destabilizuese për sigurinë afatgjate në vend.

Problem i veçantë i sigurisë, vazhdon të jetë, kontrollimi i kufirit, i cili gradualisht po kalon në përgjegjësi dhe menaxhim të SHPK-së.

Një rrezik tjetër që bazohet në shënimet jozyrtare, vjen nga armët e vogla, meqë numri i tyre kalon shifrën mbi 400 mijë armë.

Faktorët e lartshënuar tregojnë për nevojën e investimeve në ngritjen e institucioneve të sigurisë. Sektori i Sigurisë në Kosovë, nuk ka qenë nën kontrollin e autoriteteve vendore, kështu arkitektura e sigurisë është dashur të krijohet duke filluar me SHPK-në, para shatë vjetësh, që tani ka 7.300 policë dhe së fundi edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Statistika që vlerëson punën dhe efikasitetin e policisë dhe të gjyqësorit për dy kategori të krimeve, unë i kam ndarë vetëm vrasjet dhe sulmet me mjete shpërthyes.

Policia prej rasteve të vrasjeve nga viti 2000, deri në shtator 2006, që i ka zbuluar dhe i ka dërguar në prokurori dhe gjyqësi, kapin shifrën 55% të rasteve, ndërsa 45% të rasteve janë nën hetime. Kurse sulmet me mjete shpërthyes janë zbuluar rreth 44% të rasteve u janë dërguar prokurorisë dhe gjyqësorit, ndërsa 56% pra mbesin ende në procedim.

Duke u mbështetur në rastet e cekura më lartë shtrohet nevoja për strukturimin dhe reformimin e SHPK-së dhe të gjyqësorit.

Para gjashtë muajve ky Kuvend më ka dhënë mandatin politik për të drejtuar dhe ndërtuar Ministrinë e Punëve të Brendshme. Unë kam hartuar planin strategjik për ndërtimin, zhvillimin, dhe ngritjen e kapaciteteve të ministrisë për zbatimin e misionit të vet, në zbatimin e ligjit, në mbrojtjen e jetës, pasurisë, lirisë së lëvizjes, parandalimin dhe luftimin e krimit dhe korrupsionit, mbrojtjen e rendit publik, ngritjen e mekanizmave për mbrojtjen e komuniteteve, dhe deri te format e gatshme të bashkëpunimit me partner regjional e më gjerë.

Në fund, që të kemi stabilitet dhe siguri edhe më të mirë, duhet të ruhet uniteti politik, të zgjidhet statusi brenda vitit, të integrohet komuniteti serb në institucione, dhe së bashku të gjithë të marrim pjesën e përgjegjësive për përgatitjen dhe funksionimin e shtetit të ri të Kosovës.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me gjendjen e sigurisë në vend.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për gjendjen e sigurisë në vend dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Naim Maloku, Teutë Sahatçiu, Numan Baliq, Bajram Kosumi, Teutë Hadri-Ramadani, Ramadan Kelmendi, Nimon Alimusaj, Fetah Berisha, Xhavit Haliti, Gjergj Dedaj, Demir Limaj, Selvije Halimi, Emin Krasniqi, Sokol Bashota, Qibrije Hoxha, Fadil Gashi, Gani Koci, Nekibe Kelmendi, Mazllum Kumnova, Xhevdet Neziraj, Nazim Jashari, Ferid Agani, Xhelal Canziba, Ymer Muhaxheri, Agim Krasniqi, Sabri Hamiti dhe Gazmend Muhaxheri**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Në fund të debatit ministri, **Fatmir Rexhepi**, i falënderoi deputetët e Kuvendit për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, të cilat, shtoi ai do t'u shërbejnë organeve përgjegjëse të fushës së sigurisë për rritjen e cilësisë në punën e tyre.

Jakup Krasniqi, paraqiti tekstin e Deklaratës, të harmonizuar nga kryetarët e grupeve parlamentare, si vijon:

Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 19 tetor 2006, nxori këtë

D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Kosovës dënon përfshirjen e Kosovës në preambulën e Kushtetutës së ardhshme të Serbisë, si dhe organizimin e referendumit në territorin e Kosovës.

1. Kuvendi i Kosovës veprimin e shtetit serb e konsideron agresion kushtetues ndaj Kosovës,
2. Kuvendi i Kosovës pret nga Grupi i Kontaktit dhe UE-ja që aktin e Serbisë ta vlerësojnë si veprim të njëanshëm, që nuk do të ketë ndikim në statusin politik të Kosovës,

3. Referendumi i Serbisë në Kosovë është ilegal për Kosovën, prandaj nuk do të ketë efekte juridike. Mbajtja e referendumit të Serbisë në Kosovë reflekton pasiguri te qytetarët e Kosovës.
I ftojme qytetarët serbë të Kosovës të integrohen në jetën qytetare, politike, publike e institucionale,
4. Kuvendi i Kosovës është i bindur se argumenti për shtyrjen eventuale të njohjes së pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës është i paqëndrueshëm dhe mund t'i ndërlikojë proceset demokratike në Kosovë dhe në rajon.
Populli i Kosovës është sovran dhe duhet të vendosë për fatin e vet.

Kryesuesi e hodhi në votim deklaratën e paraqitur. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica e të pranishmëve;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Deklaratën kundër përfshirjes së Kosovës në preambulën e Kushtetutës së ardhshme të Serbisë.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 11:25 minuta

Kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 14:30 minuta.

E premte, 20 tetor 2006

Vazhdim i seancës

Të pranishëm ishin 68 deputetë.

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

5. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, Sadik Idrizi, sipas kërkesës së GP të ORA-s

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës ta marrin fjalën.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, në emër të grupit Parlamentar të ORA-s tha se situata në shëndetësi është shumë e rëndë.

Qeveria e Kosovës më 26 korrik të këtij viti ka formua një grup ndërministror me qëllim të përmirësimit të situatës, por çarë bëri ky grup ndërministror? A arriti ndonjë efekt pozitiv?

Sot përballemi me një krizë më të thellë në shëndetësi. Cili ishte z. ministër roli i juaj në këtë grup ndërministror? Në momentin kur u formua, ju i deleguat kompetencat tuaja, e më vonë u tha se është këshillëdhënës.

Ministria e Shëndetësisë është më e ngarkuar me staf në regjion dhe Evropë. Për secilin sektor ka nga një departament. Çka bëjnë ata? Pse Qeveria formoi Komisionin Ndërministror kur ekziston stafi menaxheria pranë ministrisë.

A është e vetëdijshme Ministria e Shëndetësisë për pasojat e grevës në QKU? Pse kjo ministri nuk është ulur me ata njerëz dhe t'i pyet për problemet e tyre?

Barnat nga lista esenciale mungojnë në të gjitha institucionet dhe në Ministri ekzistojnë fakte që kanë sjell barnat para skadimit të afatit.

Nga QKU-ja ka qenë vërejtje për statusin. A dëshironi në mënyrë autoritetare t'i impononi statutet sot tek ata njerëz. Janë dhënë vërejtje në emër të decentralizimit të Qendrës Klinike Universitare krijohen disa departamente ku prapë futen disa klinika dhe thjeshtë nuk arrihet ajo çka është kërkuar një decentralizim i mirëfilltë.

Cila është strategjia për një spital rajonal të Prishtinës?

Problemet në sektorin e shëndetësisë janë të shumta për të cilat stafi më i lartë menaxherial dhe ai politik i Ministrisë së Shëndetësisë mbanë përgjegjësinë.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi e ftoi ministrinë e Shëndetësisë të merë fjalën.

Ministri **Sadik Idrizi** - Smatram da je i cilj predlagača interpelacie (ORA) bio da se napravi jedna analiza i učini napor kako bi se poboljšalo stanje u kosovskom zdravstvu.

I pored nepovoljnog stanja u sektoru zdravstva, čega smo jako svjesni MZ je učinilo i značajna poboljšanja koja su priznata i od međunarodnih eksperata a odnose se, prije svega, na: smanjenje smrtnosti odojčadi; jedini smo na Balkanu gdje je došlo do smanjenja slučajeva obolelih od TBC-a; jedno smo od ministarstava koje je strogo poštovalo i držalo pod kontrolom broj radnika prema budžetu usvojenom od ove Skupštine; Infrastruktura u zdravstvenim institucijama je u proteklim godinama značajno popravljena; Uspjeli smo da na osnovu međunarodnih standarda izvršimo punu decentralizaciju odgovornosti na lokalni nivo; Uspjeli smo da u najvećoj mjeri kontrolišemo uvoz i kretanje farmaceutskih proizvoda uvođenjem banderola i licenci za voz; MZ u saradnji sa istražnim jedinicama KPS- a i UNMIK-a čini sve na suzbijanju negativnih pojava (mito, korupcija, falsifikovanje dokumenata); Otpočeli smo sa licenciranjem privatnih institucija (ljekarske i stomatološke ordinacije, laboratorije, poliklinike i klinike).

I pored pomenutih rezultata, stanje u zdravstvenom sektoru je opterećeno i problemima od kojih ću posebno potencirati :

Farmaceutski sektor u MZ je odgovoran za menadžiranje lijekovima (deponiranje, distribucija, disperzija) sa esencijalne liste za javni sektor.

Treba naglasiti da se sa esencijalne liste gotovo pokrivaju sve terapijske grupe u sva tri nivoa zdravstvene zaštite.

Ako se uporedi izdvojeni budžet za ove aktivnosti izlazi da je u 2003. godini bilo izdvojeno 13.250.000 eura dok je u 2006. godini izdvojeno 6.900.000 eura što je gotovo za polovinu manje. U lijekove i potrošni materijal su uključeni i citostatici i preparati HIV-a koji dosad nisu bili na esencijalnoj listi.

Vaccine iz redovnog programa vakcinisanja su takodje deo ovog budžeta.

Stanje u UKCK što se tiče zdravstvenih usluga u menadžiranju u više aspekata je palo ispod očekivanog nivoa. Taj problem nas zaokuplja u cijelom dosadašnjem periodu. Doneli smo Statut u junu mjesecu i želimo izvršiti reorganizaciju ove ustanove. Vlada je formirala radnu

Grupi za UKCK koja je predložila preporuke i mjere koje je Vlada usvojila i koje su u fazi realizacije.

Program liječenja van Kosova, takođe, predstavlja veliko opterećenje za MZ. U 2004. godini za ovaj program je izdvojeno oko 3 miliona eura, dok je u 2005. godini bilo samo 200.000 eura a u 2006. godini 500.000. U ovom trenutku je oko 1000 pacijenata na čekanju za tretman vani i za čiji su tretman potrebna sredstva u iznosu oko 7 miliona eura.

Na planu Zakonodavstva MZ je uradilo: 15 Zakona – 7 potvrđenih, dok je 8 zakona u proceduri potvrđivanja ; 40 Administrativnih uputstava (2004-2006); 28 Statuta QKMF(GCPM); 5 Statuta Regionalnih bolnica i 2 Statuta za Grdske bolnice; 1 Statut za QKUKS i 1 Statut za QKUK.

Glavni problem na zakonskom nivou ostaje Zakon o zdravstvenom osiguranju od kojeg zavisi potpuna inplementacija dobrog dijela zakona koji su potvrđeni od Skupštine kao i povećanje plata i redovno plaćanje dežurstava.

Ministarstvo Zdravstva sa uspjehom završava Licenciranje Privatnih Zdravstvenih Institucija.

Sa Sindikatom smo imali korektne odnose. Potpisali smo Sporazum koji sa dosta poteškoća realizujemo.

Na polju ispunjavanja standarda u zdravstvenom sektoru došlo je do značajnog napretka u proteklom periodu. Kako u pogledu zdravstvenih usluga tako i na planu infrastrukture manjine su od strane MZ imale ravnopravan tretman.

Moram pomenuti i saradnju na međunarodnom planu, posebno sa zemljama u regionu – Albanija, BiH, Makedonija, Turska, Slovenija, Hrvatska i dr.

Plate zaposlenima u zdravstvenom sektoru nisu povećane u protekle dvije godine niti za jedan cent. Nigdje u regionu plate nisu na tako niskom nivou. Na Kosovu po glavi stanovnika godišnje izdvaja 38 eura za zdravstvo.

Na kraju, pozivam ovu Skupštinu da pomogne zdravstveni sektor i usvoji Zakon o zdravstvenom osiguranju. Prilikom usvajanja budžeta za 2007. godinu izbori za njegovo povećanje u dijelu koji se odnosi na zdravstvo.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me interpelancën e ministrit të Shëndetësisë. Ai i njoftoi grupet parlamentare për kohën që kanë në dispozicion (dy orë) dhe ndarjen e saj në bazë të vendeve që kanë Kuvend.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për problemet në shëndetësisë në Kosovës dhe për mënyrën e dalje nga to dhanë këta deputetë: **Alush Gahi, Bajram Rexhepi, Zylfije Hundozi, Xhezair Murati, Teutë Sahatçiu, Numan Baliq, Florë Brovina, Fatmire Mulhaxha, Teutë Hadri, Ymer Halimi, Selvije Halimi, Fehmi Vula, Nazim Jashari, Naim Jerliu, Fadil Kryeziu, Zahrije Jusufi, Nafije Berisha dhe Behxhet Brajshori**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas përfundimit të debatit ministri **Sadik Idrzi** u përgjigj në vërejtjet e deputetëve për problemet në shëndetësi, të cilat, shtoi ai, Qeveria, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë do t'i marrë parasysh gjatë punës së ardhshme.

Në fund, deputetja Fatmire **Mulhaxha-Kollçaku**, në emër të parashtruesit të interpelancës, tha se nuk janë të kënaqur me punën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe me mënyrën e tyre për zgjidhjen e problemeve të shumta në fushën e shëndetësisë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Shatri** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Shatri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lutfi Zharku, Afrim Arzallxhiu, Xhevdet Neziraj, Nazim Jashari, Ali Sadrija, Florë Brovina dhe Sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 33;

Kundër----- 28.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për tatimin në vlerën e shtuar.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 14:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale